
ECONOMIC SECURITY AS A DETERMINING FACTOR FOR STATE SECURITY

Muhamet Racaj

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, muhametracaj61@gmail.com

Senat Saliu

FON University, Skopje, Republic of N. Macedonia, senat.saliu@fon.mk

Abstract: In the West, between the two wars, because of the deep economic crisis and the Great Depression, the concepts of national interest were mainly related to the social and economic well-being of states. The post-war economic remake, accompanied by the increasingly fierce military-political confrontation between superpowers, brought new meaning to national interests. In 1952, Arnold Wolfers (political science researcher) recorded this transformation as follows: "Changing the meaning of "national interest" from social welfare to security is reasonable. We live under the influence of the Cold War and under the threat of external aggression before the economic depression and social reforms¹". Until the seventies of the last century the economic problem, although it was implicitly present in all security factors, was not explicitly related to the issue of national security. However, the rapid rise of oil prices in 1973 showed dramatically that there is a strong link between foreign policy and national security on the one hand, and economic policies on the other². With the end of the Cold War and the disappearance of the bipolar world, military tensions in international relations are also diminishing. At this time of the boom of the global economy and the overall growth of economic factors came to fruition of the international relations. This is immediately reflected in the security strategies of the great powers. Thus, the US national security strategy for the first time during the nineties discusses economic issues as an integral part of security policy. For example, the United States National Security Strategy in 1991 for the first time clearly and unequivocally showed that "national security and economic strength are inseparable"³. Such a perception was associated with institutional regulation. So, for example, in 1993 it was decided that the National Security Council in the United States should also include the Minister of Finance, as well as the president's assistant for economic policy. According to the model of the National Security Council, was created National Economic Council.⁷¹

A particularly important aspect of economic security is energy security, which was incorporated in the US strategy in 1996⁴.

The global economic crisis, which began in 2008, will further accelerate this process of securitization in the economic field. This is clearly reflected in the 2010 US National Security Strategy, which states that "at the core of our commitment are our efforts to rebuild our economy, which serves as a source of US power."⁵ The expansion of the understanding of security in economic matters has also been confirmed in the National Security Strategy in almost all Balkan countries.

The purpose of this chapter is, first of all, to emphasize the different meanings of economic security. Thereafter, we will provide a framework for understanding complex relationships through the development of the economic security sector as an analytical subject. Finally, in the last section will be addressed the most important economic threats.

Keywords: security, economy, national

⁷¹Wolfers, 1952, 482.

Oil strikes were caused by oil-producing countries, imposing embargoes (OPEC) on oil exports to the United States and other Western countries due to their support for Israel during the Yom Kippur war against Egypt and Syria in 1973. As a result, the price of oil on the world market in just one year quadrupled.

National Security Strategy of the United States, August 1991. Source: <http://www.fas.org/man/docs/918015-nss.htm> (30 september 2010).

De Suoza, 2000.

National Security Strategy of the United States, May 2010. Source: http://www.whitehouse.gov/sites/default/files/rss_viewer/national_security_strategy.pdf (5 November 2011).

SIGURIA EKONOMIKE SI FAKTORË DETERMINUES PËR SIGURINË E SHTETIT

Muhamet Racaj

Kolegji i Biznesit, Prishtinë, Republika e Kosovës, muhametracaj61@gmail.com

Senati Saliu

Universiteti FON, Shkup, Republika e N. Maqedonisë, senat.saliu@fon.mk

Abstrakt: Në perëndim, në periudhen në mes dy luftërave, për shkak të krizës së thellë ekonomike dhe depresionit të madh, konceptet e interesit kombëtar kryesisht ishin të lidhura me mirëqenien sociale dhe ekonomike të shteteve. Rimëkëmbja ekonomike e pasluftës, e shoqëruar me konfrontimin gjithnjë e më të ashpër ushtarako-politik mes superfuqive, solli kuptim të ri për interesat kombëtare. Në vitin 1952, Arnold Wolfers (studiuues i shkencave politike), këtë transformim e regjistroi në mënyrë si në vijim: “Ndryshimi i kuptimit të “interesit nacional” prej mirëqenjes shoqërore në drejtim të sigurisë është e arsyeshme. Në jetojmë nën ndikimin e Luftës së Ftohtë dhe nën kërcënimin e agresionit të jashtëm para depresionit ekonomik dhe reformave sociale”.⁷² Deri në vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar problemi ekonomik, edhe pse në mënyrë implicite ishte i pranishëm në të gjithë faktorët e sigurisë, nuk ishin të lidhura në mënyrë eksplicite çështjen e sigurisë kombëtare. Megjithatë, ngritja e shpejtë e çmimit të naftës në vitin 1973 tregoi në mënyrë dramatike se ekziston një lidhje e fortë në mes të politikës së jashtme dhe të sigurisë kombëtare nga njëra anë, dhe politikat ekonomike, nga ana tjetër.⁷³ Duke i dhënë fund Luftës së Ftohtë dhe me zhdukjen e botës bipolare, zvogëlohen edhe tensionet ushtarake në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në këtë kohë erdhi deri te lulëzimi i ekonomisë globale dhe rritja e përgjithshme e faktorëve ekonomik në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo është reflektuar menjëherë në strategjitë e sigurisë të fuqive të mëdha. Kështu, strategjia e sigurisë kombëtare amerikane për herë të parë gjatë viteve të nëntëdhjeta i diskuton çështjet ekonomike si pjesë integrale e politikës së sigurisë. Për shembull, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara në vitin 1991 për herë të parë qartë dhe pa dyshim u tregua se “siguria kombëtare dhe forca ekonomike janë të pandashme”.⁷⁴ Një përcëptim i tillë u shoqërua me rregullim institucional. Kështu, për shembull, në vitin 1993 u vendos që në Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mer pjesë edhe Ministri i Financave, si dhe ndihmësi i presidentit për politikën ekonomike. Sipas modelit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, u krijua edhe Këshilli Ekonomik Kombëtar. Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm në sigurinë ekonomike e krijon siguria e energjisë, e cila në strategjinë amerikane u fut në vitin 1996.⁷⁵

Kriza ekonomike globale, e cila ka filluar në vitin 2008, do ta përshpejtojë më tej këtë proces të sekuritarizmit në fushën ekonomike. Kjo pasqyrohet qartë në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vitin 2010, në të cilën theksohet se “në qendër të angazhimit janë përpjekjet tona për të ripërtërirë ekonominë tonë, e cila shërben si burim i fuqisë amerikane.”⁷⁶ Zgjerimi i kuptimit të sigurisë në çështjet ekonomike është konfirmuar edhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare pothuajse në të gjitha shtetet ballkanike.

Qëllimi i këtij kapitulli para së gjithash është të theksojmë kuptimet e ndryshme të sigurisë ekonomike. Pas kësaj, ne do të ofrojmë një kornizë për të kuptuar marrëdhëniet komplekse nëpërmjet zhvillimit të sektorit të sigurisë ekonomike si lëndë analitike. Së fundi, në pjesën e fundit do të bëhet shqyrtimi i kërcënimeve më të rëndësishme ekonomike.

Fjalët kyqe: sigurisë, ekonomike, kombëtare.

1. KUPTIMI I SIGURISË EKONOMIKE

Në kuptimin më të gjerë të mundshëm, siguria ekonomike i referohet tendencës drejt lirisë së kërcënimeve ekonomike. Në kuptimin e ngushtë, të paktën ka pesë kuptime të ndryshme të sigurisë ekonomike.⁷⁷ Së pari, në të

⁷² Wolfers, 1952, 482.

⁷³ Goditjen e naftës e shkaktuan vendet prodhuese të naftës, vendosen embargo (OPEC) mbi eksportet e naftës në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera perëndimore për shkak të mbështetjes së tyre për Izraelin gjatë luftës Yom Kippur kundër Egjiptit dhe Sirisë në vitin 1973. Si rezultat, çmimi i naftës në tregun botëror për vetëm një vit u katërfishuar.

⁷⁴ National Security Strategy of the United States, August 1991. Burimi: <http://www.fas.org/man/docs/918015-nss.htm> (30. shtetor 2010).

⁷⁵ De Souza, 2000.

⁷⁶ National Security Strategy of the United States, May 2010, Burimi: http://www.whitehouse.gov/sites/default/files/rss_viewer/national_security_strategy.pdf (5. Novembar 2011).

⁷⁷ Cable, 1995.

nënkuptohet prodhimi dhe tregtia, që ndikojnë direkt në aftësinë e mbrojtjes së shtetit. Kjo kryesisht ka të bëjë me prodhimin dhe tregtinë e teknologjisë ushtarake dhe armëve, si dhe nevoja të tjera kritike të rëndësishme për sistemin e mbrojtjes, për shembull duke përfshirë në të minerale strategjike që janë esenciale për prodhimin e avionëve (p.sh., kobalt, mangan, krom, platinum, etj), produktet e energjisë (p.sh.. naftë dhe gaz), produkte ushqimore, informacionet e avancuara dhe nanoteknologjitë, etj. Megjithatë se cilat janë furnizimet kyçe të mbrojtjes kombëtare është pyetje relative, ndërsa përgjigjeja për të do të varet nga vlerësimi politik, konteksti dhe perceptimet aktuale të sigurisë. Kështu, për shembull, qeveria e Suedisë në vitin 1975 thirret në nenin 21 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT), e cila lejon kufizimet tregtare në kohë lufte ose gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ndërkombëtare, për të vendosur sasinë për importin e këpucëve. Atëherë arsyetimi i qeverisë Suedeze ishte se reduktimi i prodhimit vendas të këpucëve do të jetë kërcënim për planifikimin e jashtëzakonshëm të mbrojtjes ekonomike, e cila është parashikuar nga politika e sigurisë së shtetit.⁷⁸

Kuptimi i dytë i sigurisë ekonomike i referohet instrumenteve të politikës ekonomike, të cilat përdoren si mjete ofanzive ose defanzive të politikës së sigurisë. Kjo mund të jetë bojkot ose kufizime për furnizimin me energji, sanksionet dhe forma të ndryshme të ndihmës ekonomike. Për shembull, shtetet arabe kanë shfrytëzuar pozitën e tyre dominuese në prodhimin e naftës të papërpunuar (OPEC) për të ndikuar në politikën e saj në Lindjen e Mesme dhe në SHBA. Për këtë arsye, presidenti amerikan Richard Nixon dhe Sekretari Shtetror Henry Kissinger filluan negociatat me Izraelitët, të cilët kanë rënë dakord që të tërhiqen nga Sinai dhe Golani. Tërheqja e tillë ka bindur prodhuesit arabë të naftës për të tërhequr embargon në fillim të marsit në vitin 1974. Shembulli më i fundit i përdorimit të furnizimeve të energjisë për qëllime politike, është refuzimi i Rusisë për të furnizuar me gaz Ukrainën në vitin 2006 dhe Bjellorusinë në vitin 2007, vendet nëpër të cilat kalon i gjithë gazi rus i destinuar për Bashkimin Evropian. Edhe pse pala ruse pohoi se motivet e pezullimit janë të natyrës ekonomike, nuk ka dyshim se ai pezullim kishte efekte të rënda politike dhe të sigurisë.⁷⁹ Nga samiti i NATO-s në Rīgë, në dhjetor të vitit 2006, por edhe pas kësaj kohe, siguria e energjisë është një nga temat kryesore që tërheqin vëmendjen e vendimarrësve në aleancat ushtarake. Ka edhe sugjerime që neni i pestë i Traktatit të Uashingtonit të zgjerohet në mënyrë që pezullimin e furnizimit me energji ndaj një shteti anëtar të trajtohet si një sulm ndaj tërë aleancës.⁸⁰ Sanksionet ekonomike të tilla si ato të vendosura ndaj Iranit lidhur me dyshimet se ai është duke zhvilluar programin ushtarak bërthamor dhe bojkotet e produkteve izraelite në botën arabe janë gjithashtu një instrument i politikës ekonomike, e cila është përdorur për qëllime të caktuara politike dhe objektive, të sigurisë.

Kuptimi i tretë i sigurisë ekonomike është aftësia për të mbajtur një nivel të caktuar të zhvillimit ekonomik në funksion të sigurisë së brendshme dhe stabilitetit të sigurisë ose përmirësimi e pozitës ndërkombëtare politiko-ushtarake të ndonjë vendi. Për zhvillimin ekonomik si një mjet për të arritur sigurinë e brendshme mbi të gjitha janë të interesuara shtetet e vogla dhe shtetet e dobëta.⁸¹ Shtetet e forta dhe të fuqishme ruajtjen e fuqisë ekonomike e trajtojnë si mënyrë për të siguruar statusin e tyre si fuqi rajonale, fuqi e madhe apo superfuqi. Shumë autorë, duke përfshirë edhe Paul Kennedy kanë vënë në dukje se gjatë gjithë historisë ka një korrelacion të fortë midis aftësive ekonomike, nga njëra anë dhe aftësinë për të mbijetuar, nga ana tjetër.⁸² Këtë e njeh edhe Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e vitit 2010, duke deklaruar se "në qendër të angazhimit të përpjekjeve tona kryesisht të ripërtërihet ekonomia jonë, e cila shërben si burim i fuqisë amerikane".⁸³ E njëjta logjikë është përdorur edhe nga ana fuqive tjera të mëdha. Megjithatë, disa prej tyre, përveç se kanë fuqi të madhe, në të njëjtën kohë dhe janë edhe shtete të varfëra, dhe zhvillimi ekonomik është identifikuar me kohezionin e brendshëm socio-politik. Kështu, për shembull, në Kinë ruajtja e zhvillimit ekonomik në nivelin të lartë të rritjes ekonomike, trajtohet si një problem i rëndësishëm jo vetëm për pozicionin ndërkombëtar dhe prestigjin e Kinës, por edhe për stabilitetin e brendshëm të shoqërisë dhe shtetit. Ndalimi i rritjes ekonomike mund krejtësisht të destabilizojë legjitimitetin e partisë qeverisëse komuniste. Më keq se kaq, kjo mund të hapë rrugën për pluralizmin e pakontrolluar të shoqërisë dhe forcave centrifugale politike. E gjithë kjo mund të ketë pasoja të pasigurta dhe potenciale me ndikim të gjerë të sigurisë jo vetëm për Kinën edhe për rajonin e Azisë Lindore, por për mbarë botën. Kuptimi i katërt i sigurisë ekonomike ka të bëjë me sigurinë ekonomike të individit. Në këtë pikë, nocioni i sigurisë ekonomike i afrohet kuptimit të termeve të ndërlidhura, të tilla si sigurimet shoqërore ose siguria njerëzore. Siguria

⁷⁸ Ibid., 313.

⁷⁹ Para së gjithash, për shkak se ajo ilustron se si politika e energjisë mund të përdoret si një instrument i politikës së jashtme dhe të sigurisë. Radoman 2007.

⁸⁰ Një propozim i tillë e ka paraqitur senatori amerikan Richard Lugar. Radoman 2007.

⁸¹ Strategjia, 10.

⁸² Pol Kenedi, 2003

⁸³ National Security Strategy of the United States, May 2010, 2 Burimi: http://www.whitehouse.gov/sites/default/files/rss_viewer/national_security_strategy.pdf (5. November 2011).

ekonomike e individit mund në kuptim të ngushtë të definohet si qasje në ushqim, ujë të pijshëm dhe përbërësve tjerë, ose kushtet që janë të nevojshme për mbijetesën fizike të individit. Në kuptimin e gjerë, siguria ekonomike e individit i përfshin edhe temat të tilla si varfëria, shëndetësia, arsimi. Koncepti i sigurisë njerëzore, i cili në vetë përfshin këtë nocion të sigurisë ekonomike, në dekadat e fundit erdhi në rendë të ditës në politikën ndërkombëtare. Disa vende, të tilla si Kanadaja, Norvegjia dhe Japonia, në këtë koncept e bazojnë politikën e tyre të jashtme dhe të sigurisë. Kuptimi i pestë dhe i fundit i sigurisë ekonomike është e lidhur me stabilitetin ekonomik global, social dhe ekologjik. Kuptimi i sigurisë ekonomike i vendosur në këtë mënyrë përfshin një gamë të gjerë temash, si stabilitetin e sistemit global financiar dhe ekonomik, anën e errët të tregut global (p.sh., trafiket e paligjshme të narkotikëve, armëve, terrorizmi global, piraterisë, etj), shterja e burimeve jo të rinovueshme, ndotja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike. Kriza ekonomike globale që goditi së pari SHBA-të, dhe pastaj pjesën tjetër të botës në vitin 2008 është vendosur në krye të rendit të ditës kryesisht interpretimin e tillë të sigurisë ekonomike. Problemi kryesor i ballafaqimit të rastit me kuptimin e problemeve të sigurisë ekonomike është mungesa e qeverisjes globale që mund të menaxhojë aktivitetin ekonomik global. Në vend të kësaj, rendi liberal ekonomik ndërkombëtar e ka ruajtur stabilitetin e saj gjatë dy shekujve të fundit në sajë të rolit të parë hegjemonist të Britanisë së Madhe në shekullin e XIX, dhe pastaj të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në shekullin e XX. Megjithatë, periudha në mes të rënies së fuqisë relative ekonomike, politike dhe ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar, e cila ka ndodhur në fillim të shekullit XX dhe në momentin kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës morën përsipër rolin hegjemonist në fund të Luftës së Dytë Botërore, është shënuar kolapsi i tregjeve globale dhe rivendosjen e fuqive të mëdha merkantiliste politike si dhe luftërave botërore.

2. SEKTORI I SIGURISË EKONOMIKE

Në Sektorin e sigurisë ekonomike dominante janë marrëdhëniet tregtare dhe të prodhimit. Megjithatë, është pak më e vështirë për të identifikuar objektin e referimit të sigurisë ekonomike, sepse ajo varet nga niveli i analizës. Në nivel individual, ajo është në mirëqenien e individëve që mund të definohen në terme të ngushta në kuptimin thjeshtë të mbijetesës – të cilat përfshijnë një korpus të të drejtave të njeriut. Në shoqëritë liberale - demokratike shteti shqetësohet për sigurinë ekonomike të individëve, por vetëm në një masë të caktuar, e cila përsëri varet nga ajo nëse shoqëria a është e prirur ndaj vlerave sociale apo liberale. Megjithatë, edhe në të ashtuquajturat, shtetet e mirëqenies nuk është e lehtë për të garantuar të gjithëve sigurinë e plotë ekonomike (p.sh. punësimit të plotë), këtu secili merr një sasi të caktuar të rrezikut. Nga ana tjetër, në shtetet e dobëta ekonomikisht dhe politikisht, siguria ekonomike e individit, është si rregull, më pak i rëndësishëm se prioritetet politike apo ekonomike kolektive. Në nivel të shoqërisë, objekt referimi i sigurisë ekonomike mund të jenë ndërmarrjet apo kategoritë.

Megjithatë, ndërmarrjet në një shoqëri liberale nuk kanë shumë shansë të paraqesin mbijetesën e tyre si një çështje të rëndësishme për sigurinë kombëtare. Logjika kapitaliste supozon se ndërmarrjet, sikurse individët, duke marrë pjesë në treg marrin edhe një pjesë të rrezikut në qoftë se ato janë më pak produktive se të tjerët, humbin fitime ose tërësisht zhduken. Në çdo ekonomi liberale, çdo ditë krijohen dhe zhduken një numër i madh i ndërmarrjeve, dhe shumë rrallë mbijetonë ndonjë prej tyre dhe kjo paraqet një problem të sigurisë. Mbijetesa e ndërmarrjeve të caktuara ndoshta mund të jetë sekuritarizive në qoftë se është fjala për ndërmarrjet publike ose private, të cilat kanë rëndësi kritike për mbrojtje apo për funksionimin e ekonomisë së shtetit. Për shembull, në SHBA kompanitë e mëdha përgjegjëse për transportin dhe përpunimin e naftës trajtohet si shumë të rëndësishme dhe qw mos të vijë deri te rwnja e tyre, ato qeveria i subvencionon dhe e krediton pa kamatë. Pas krizës financiare të vitit 2008, qeveritë e shumë shteteve kanë dhuruar shuma të mëdha parash për të shpëtuar nga falimentimi ndërmarrjet të cilat janë vlerësuar se jenë me rëndësi kritike për sistemin ekonomik dhe sigurinë kombëtare.⁸⁴

Klasa ekonomike gjithashtu është objekt referimi problematik i sigurisë, duke pasur parasysh se asaj i mungon koherenca dhe aftësia për të shfaqur qendrimet e veta ekonomike si objekt referimi i sigurisë kombëtare ose sigurisë ndërkombëtare. Në qoftëse bëhet fjalë për klasën më të lartë, mbajtja e tyre në kulmin ekonomik, në shoqëritë liberale-demokratike trajtohen, të paktën jo në mënyrë eksplicite, si prioritet të sigurisë. Nëse flasim për klasën punëtore, për dallim nga gjysma e parë e shekullit XX, është se sot ajo nuk ka fuqi të mjaftueshme institucionale dhe ideologjike, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, që pozita e tyre ekonomike me sukses të sekuritizedhe dhe për masat e veçanta të fitojë mbështetjen e publikut më të gjerë. Për shembull, retorika e presidentit amerikan Barak Obama shpesh i drejtohej klasës së mesme të pambrojtur. Megjithatë, është e vështirë të thuhet nëse ka sekuritarizëm apo vetëm politizim, për shkak të faktit se shumë rrallë ndodh që nga ky diskurs në klasën e

⁸⁴ Tetor viti 2008. Kongres i SHBA-ve ka miratuar ligjin e vlerave të stabilitetit ekonomik (engl. Emergency Economic Stabilization Act), i cili ka parashikuar 700 miliardë dollarë ti ipen si ndihmë për bankat që janë rezikuar nga kriza ekonomike.

mesme e cila klasë është e rrezikuar, të lindin edhe masat e veçanta kundër klasave tjera, të cilat me siguri do të kanë dallime të ashpëra me rendin dhe vlerat liberale – demokratike.

Në nivel shtetëror, në kuptimin më të përgjithshëm, objekti i referimit paraqet mirëqenien e vet të përgjithshme ekonomike, apo nivelin e arritur të zhvillimit ekonomik. Megjithatë, përpjekjet e këtij abstrakti të objektit të referimit të sigurisë ekonomike, japin përmbajtje më konkrete, dhe fitohen rezultate të ndryshme në varësi të asaj se nëse fillon nga pikëpamja liberale apo merkantiliste në ekonomin politike. Ndërsa ekonomia liberale politike është e angazhuar për ekzistencën e tregut të lirë brenda vendit dhe integrimin e tij në tregun global, **ndërsa ekonomia merkantiliste politike do të thotë mbrojtjen e ekonomisë kombëtare nga konkurrenca ndërkombëtare dhe përpqet të vetë-furnizohet në sa më shumë fusha të prodhimit.** Nëse për liberalët është e rëndësishme që tregu të jetë i lirë, për (neo) merkantilistët thelbësore është që ekonomia e vendit të jetë autonome. Në varësi të asaj se cila pikëpamje ekonomike mbizotëron, do të varet edhe objekti i referimit të sigurisë ekonomike në nivel shtetëror. Nëse mbizotëron të menduarit liberal, objekt referimi i sigurisë ekonomike do të jetë liria ekonomike, e cila është kusht paraprak i zhvillimit ekonomik. Megjithatë, nëse mbizotëron kuptimi merkantilist i ekonomisë, objekti referimi do të jetë aftësia e shtetit që vetë të prodhojë atë që është e nevojshme për mbijetesë, por edhe aftësia e saj prodhuese me konkurrencën ndërkombëtare.

Së fundi, objekt referimi në nivel ndërkombëtar paraqet rendin liberal ekonomik ndërkombëtar.⁸⁵ Kjo është një gamë e tërë e aktorëve lidhës, institucionet dhe parimet, të cilat mundësojnë funksionimin normal të tregut botëror. Në mesin e aktorëve mbi të gjitha janë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës si hegjemoni e tanishme, si dhe fuqitë e tjera të mëdha, të cilat si aktorët më të fuqishëm ekonomikë dhe politikë në sistemin ndërkombëtar kanë interes të ruajnë funksionimin normal të tregut global. Përveç këtyre ka edhe një numër të madhë të organizatave ndërkombëtare si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata Botërore e Tregtisë dhe të tjera, të cilat ofrojnë kornizë institucionale të parimeve dhe normave që rregullojnë rendin liberal ekonomik ndërkombëtar. Sipas teorisë klasike liberale të marrëdhënieve ndërkombëtare, ky rend liberal ndërkombëtar ekonomike jo vetëm që e nxit konkurrencën, që në këtë mënyrë e zhvillon pasurinë për të gjithë, por edhe pozitivisht ndikon në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërshtetërore. Argumenti kryesor i “teorisë së paqes liberale”, është se shtetet lidhen aq ngushtë në tregun botëror dhe të jenë të ndëravura njëra prej tjetrës sa që lufta nuk do të jetë me kosto efektive (e pagueshme). Për më tepër, pasi që ata të kenë qasje të lirë në tregjet e huaja dhe se pushteti politik nuk varet drejtë për së drejti nga kontrolli i territorit imperialistë, fuqitë e mëdha në këto rrethana nuk do të konkurrojnë për epërsi në armatim, por në mënyrë paqësore do të konkurrojnë për kontrollin e tregut.⁸⁶ Megjithatë, nëse shteti mbyllet në vetvete dhe kthen politikën merkantiliste, sipas perceptimit të teorisë liberale kjo do të çojë në një situatë të rrezikshme konkurrese nacionaliste dhe në shkallen më të keqe shpërthimin e luftës.

Megjithatë, siç tregohet nga Barry Buzan, as liberalizmi, as merkantilizmi në vetvete nuk çojnë as në paqe e as në luftë. Për ta kuptuar, se paqja që zgjati shumë kohë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, është e patjetërsueshme të merren në konsideratë faktorët jo- ekonomike, të tilla si teknologjia ushtarake (p.sh. Bombë bërthamore spastruan diferencën midis fitores dhe humbjes) dhe struktura politike e sistemit ndërkombëtar (p.sh. stabilitetit bipolar).⁸⁷

Aktorët e sekuritarizmit në sigurinë e sektorit ekonomik kryesisht varen nga niveli i analizës. Kur është fjala për nivelin individual, aktorët dominuese të sekuritarizmit përveç qeverisë që kanë pranuar konceptin e sigurisë njerëzore, janë edhe organizatat jo-qeveritare, mbrojtësit e të drejtave të njeriut në një masë të caktuar, organizatat ndërkombëtare, si OKB-ja, e cila në konceptin e saj të sigurisë njerëzore e ka të përfshirë në diskursin e vet normativ. Kur flasim për sigurinë ekonomike në nivelin e shoqërisë, aktorët e sekuritarizmit gjithashtu mund të jenë të ndryshëm. Në qoftë se bëhet fjalë për ndërmarjet që kanë rëndësi strategjike për sigurinë kombëtare, aktorët e sekuritarizmit më shumti janë përfaqësues të shtetit, pasi që përfaqësuesit e ndërmarjeve në fjalë, në përgjithësi nuk kanë kapital të mjaftueshëm social për të kryer aktin e tyre të sekuritarizmit në emër të vet. Në rastin e klasës sekuritariste, kjo mund të jetë lëvizje e punës (për klasën punëtore) apo përfaqësues të partive politike në pushtet, të opozitës, ose civile (klasa e mesme). Në nivel shtetëror, aktorët e sekuritarizmit janë përfaqësues e shtetit. Në qoftë se është fjala për sekuritarizimin e tregut të brendshëm të lirë ata mund të bashkohet me elitën liberale intelektuale dhe ekonomike. Përfundimisht, në nivel ndërkombëtar, aktorët ekonomik të sekuritarizmit janë kryesisht hegjemonitë në rënie, që marrin shumicën e rendit liberal ndërkombëtar, por mund edhe më shumë të humbin vullnetin e tyre. Atyre u janë bashkuar organizatat fiannciare ndërkombëtare dhe elitat liberale ndërkombëtare.

⁸⁵ Është interesante se në sektorin ekologjik, rendi liberal ekonomik ndërkombëtar paraqet kërcënimin kryesor.

⁸⁶ Lenini kishte pohuar të kundërtën, dhe ajo ishte se fuqitë kapitaliste imperiale, sapo të pushtojnë tërë botën do të fillojnë luftë ndërmjet vete për dominim, e cila me sa duket erdhi në pahë gjatë Luftës I Botërore. Lenini, në vitin 1975.

⁸⁷ Buzan, 1984.

3. KËRCËNIMET E SIGURISË EKONOMIKE

3.1. Kërcënimet ekonomike të sigurisë individuale

Në nivel individual, si kërcënimet kryesore ekonomike të sigurisë theksohen më shpesh varfëria, sëmundjet dhe uria. Aktualisht 2.5 miliardë njerëz në botë jetojnë në varfëri (më pak se dy dollarë në ditë për individ), ndërsa 1.4 miliardë njerëz jetojnë në varfëri të skajshme (më pak se 1, 25\$ në ditë).⁸⁸ Është e vërtetë se përqindja e popullsisë së botës që jeton në varfëri në dekadat e fundit ka pasur rënje. Për shembull, vetëm në Kinë që nga viti 1981, deri më tani varfërisë ju shmangen më shumë se gjysmë miliardë njerëz. Përparime të mëdha janë bërë në Indi dhe në Amerikën Latine. Megjithatë, në disa rajone, të tilla si në Afrikën Sahariane, shkalla e varfërisë është dyfishuar në dy dekadat e fundit. Pavarësisht këtyre dallimeve rajonale, varfëria është ende një kërcënim i madh ekonomik për sigurinë e individit, sepse ajo është e ashtuquajtura shumëzues i shumë kërcënimeve të tjera, të tilla si uria, sëmundjet dhe dhuna. Sipas UNICEF-it, 22.000 fëmijë vdesin çdo ditë në botë (më të vegjël se pesë vejt), kryesisht për shkak të problemeve që dalin nga varfëria. Ajo është rreth shtatë herë më shumë se numri i përgjithshëm i viktimave të sulmit terrorist të kryer më 11 shtator të vitit 2001.⁸⁹

Varfëria është e lidhur ngushtë me kërcënime të tjera ndaj sigurisë njerëzore, siç janë sëmundjet apo uria. Një numër i madh i sëmundjeve infektive në dekadat e fundit janë shpërndarë në të gjithë botën, të tilla si SARS, SIDA, hepatiti C, virusi H5N1, virusi Ebola, të cilat janë shfaqur vetëm në vendet më të varfra të botës. Në Afrikën Sahariane, ku është shënuar rasti i parë i sëmundjes të SIDËS, (në Kongon Belge në vitin 1959), rreth 5% e popullsisë vuajnë nga kjo sëmundje, ndërsa në disa vende virusi HIV ka infektuar një të katërtën e popullsisë (Swaziland 26.1%, 23.9%, Botsvana, Lesoto 23.2%, Afrika e Jugut 18.1%).⁹⁰ Në këtë pjesë të botës gjenden rreth 67% nga numri i përgjithshëm në botë që janë infektuar nga HIV (prej 33 milionë), si dhe 75% e numrit të përgjithshëm të vdekjeve në vit të shkaktuara nga SIDA.⁹¹ Me 25 milionë viktima, SIDA është epidemia e dytë më vdekjeprurëse në histori, por për momentin ende është prapa murtajës, e cila në shekullin e XIV ua mori jetën rreth 75 milionë evropianëve.⁹² Përveç SIDA e cila në total mori jetën e 2.9 miliona viktimave në vit, në mesin e shteteve të varfura edhe sëmundjet tjera vdekjeprurëse e kanë rritur numrin e viktimave, për shembull, sëmundjet e frymëmarrjes (3,9 milion), dijareja (2,1 milion), tuberkuloza (1,7 milion) dhe malarija (1,1 milion).⁹³

Në vitin 2010, në botë ka pasur rreth një miliard njerëz të uritur.⁹⁴ Megjithatë, shkak i urisë nuk është i natyrës demografike, siç e parashikoi Thomas Robert Malthus (shkenctarë anglez/ekonomia politike dhe demografike) në fund të shekullit XVIII.⁹⁵ Në sajë të teknologjisë bashkëkohore bujqësore, bota posedon kapacitet për të prodhuar ushqim të mjaftueshëm për të gjithë. Uria rrjedh nga kombinimi i varfërisë, politikës dhe rreziqeve ekologjike.⁹⁶ Uritë më të mëdha shkaktohen nga veprimi të qëllimshëm politik. Për shembull, në Kinë ndërmyet viteve 1958 dhe 1962 vdiqën nga uria rreth 30 milionë njerëz, kryesisht për shkak të urbanizimit të dhunshëm dhe kolektivizimit. Politika Sovjetike, e drejtuar kundër nacionalizmit Ukrainas, ishte vendimtare në rastin e urisë së madhe në Ukrainë në vitet 1932-1933, e cila ua mori jetën pesë milionë njerëzve, të cilën shumë shtete sot e trajtojnë si formë e gjenocidit. Megjithatë në disa raste tjera, ishin faktorët kritik natyror, të tilla si thatësira, e cila në Kinë nga viti 1876 deri 1878, ka marrë jetën e 12 milionëve, apo thatësirat në Bengal (tani Bangladesh), e cila në vitin 1770 mori jetën e rreth 10 milionëve.⁹⁷ Është e rëndësishme të theksohet se studiuesit janë dakord se faktorët distributiv (shpërndarës) dhe politikë janë shkaqet kryesore të urisë. Filozofi Indian dhe fituesi i çmimit Nobel për ekonomi Amartya Sen, në veprat e tij tregoi se uria nuk vjen si pasojë e mungesës së ushqimit, por si rezultat i pabarazisë ekonomike dhe politike. Për më tepër, ai tregoi se mungesat masive të ushqimit nuk ndodhin në shtetet demokratike.

⁸⁸ Rice, 2010.

⁸⁹ Të dhënat për vitin 2010. Burimi: http://www.unicef.org/media/media_56045.html (2. tetor 2010).

⁹⁰ Të dhënat për vitin 2007. UNSIDA 2008.

⁹¹ Ibid.

⁹² Ibid., 31.

⁹³ Hough, 2004.

⁹⁴ Burimi: <http://www.bread.org/hunger/global/> (2. tetor 2010).

⁹⁵ Në pjesën mbi parimin e popullsisë njerëzore nga viti 1798. Thomas Malthus supozon se popullsia njerëzore rritet në mënyrë eksponenciale në krahasim me furnizimin me ushqime, e cila rritet në mënyrë aritmetrike. Prandaj, njerëzimi, sipas mendimit të tij, në qoftë se ju nuk e kontrollojnë rritjen e popullsisë, herët a vonë të përballen me uri masive.

⁹⁶ Hough, 2006, 86.

⁹⁷ Ibid., 86.

3.2. Kërcënimet ekonomike ndaj sigurisë së shtetit

Varfëria nuk është vetëm kërcënim ndaj sigurisë së individit, por shpesh është trajtuar si kërcënim ndaj sigurisë kombëtare.⁹⁸ Varfëria është një nga shkaqet kryesore të dobsimit të shtetit.⁹⁹ Për shembull, shtetet që janë të varfëra janë në mesin e shteteve më të dobëta, dhe anasjelltas, shtetet më të pasura në botë janë kryesisht në mesin e shteteve më të fuqishme.

Shtetet e varfra gjithashtu kanë një rrezik shumë më të madhë të hyjnë në lufta civile se sa ato të pasurat. Sipas disa vlerësimeve, shtetet që kanë 250 dollarë PBB (Prodhimi bruto i brendshëm) për kokë banori kanë 15 % rrezik për të qenë të prekur nga lufta civile në pesë vitet e ardhshme, ndërsa për një shtet që ka 5,000 \$ PBB (Prodhimi bruto i brendshëm) për kokë banori, kjo mundësi është më pak se 1 %.¹⁰⁰ Njëkohësisht, nëse shpërthen një luftë civile, niveli i varfërisë ndikonë në kohëzgjatjen e konfliktit, dhe kur ajo mbaron, varfëria mund të ketë ndikim të rëndësishëm në mundësinë e ri-shfaqjes së konfliktit.¹⁰¹ Përveç rreziqeve të ritura për shpërthimin e luftës civile, varfëria krijon kushte të favorshme për zhvillimin e terrorizmit dhe ekstremizmit. Për shembull, Jemeni është vendi më i varfër në Lindjen e Mesme, me 40% të popullsisë që jetojnë nën kufirin e varfërisë. Ky shtet gjithashtu është një nga vendet ku rrjeti terrorist islamik është më i zgjeruar. Besohet se shtetasi nigerian Omar Faruk Abdulmutallab, i cili për Krishtlindjet e vitit 2009, u përpoq të hidhte në ajër aroplanin që fluturonte prej Amsterdamit drejt Detroitit, është trajnuar vetëm në Jemen, ku edhe një kohë atje edhe ka studiuar. Siç thotë Barak Barfi, një studiues në Institutin Brookings, “ka një arsye pse në Guantanamo ka më shumë jemenas; ekziston arsyeja pse kaq shumë prej tyre shkuan në Irak dhe tani në Liban (...) Atje është mjedisi pjellore radikal”.¹⁰² Ajo arsye është varfëria e madhe. Situata është e ngjajshme edhe me vendet e tjera të rajonit, të Lindjes së Mesme, nga Senegali në Jemen, ku në vend të shtetit, i cili nuk është në gjendje të kontrollojë pjesë të territorit të vet dhe sigurimin e të mirave publike për qytetarët e vetë, shfaqen rrjetet fundamentaliste islamike me shërbimet e tyre sociale (shkolla, spitale, xhami), por edhe me idetë e tyre ekstremiste dhe kampet e trajnimit terroriste. Problemi tjetër që shpesh nuk trajtohet si kërcënim për sigurinë kombëtare është deficit i energjisë. Pa sasi të mjaftueshme të energjisë, shteti mund të përjetojë kolaps ekonomik, politik dhe social. Për më tepër, pa furnizim stabil, shteti nuk mund ta organizojë sistemin e vetë të mbrojtjes, e as ta ruaj stabilitetin e brendshëm dhe të sigurisë. Sipas përkufizimit klasik, siguria e energjisë paraqet disponueshmëri (qasje) të mjaftueshme të sasisë së energjisë me çmime të arsyeshme. Çka do të thotë kjo për një shtet konkret, nvarret prej rastit në rast. Shtetet prodhuese të burimeve natyrore të energjisë për shembull, Arabia Saudite, Irani, Rusia dhe Venezuela mbi të gjitha janë të interesuara për kërkimin e naftës dhe gazit, pasi që prej atyre burimeve varet një pjesë e madhe e ekonomisë së tyre. Nga ana tjetër, shtetet që janë të varura për energji, dhe të tillë janë shumica e shteteve në botë, Shtet e tilla me sigurinë energjetike nënkuptojmë “ofertë të sigurtë”, ose disponueshmërinë e energjisë në çmime më të ulëta.¹⁰³ Jonathan Elkind (ekspertë amerikan për politikë energjetike) thekson se siguria e energjisë ka katër elemente. E para është disponueshmëria e mallrave dhe shërbimeve të energjisë.¹⁰⁴ Kjo varet nga disponueshmëria fizike e energjisë, kapaciteti i shteteve për prodhim, shtetet e tranzitit dhe shtetet të konsumit të bien dakord mbi kushtet e tregtisë, si dhe nga parakushtet teknologjike për prodhimin, transportin, konvertimit, magazinimin dhe shpërndarjen e energjisë. Elementi i dytë i sigurisë së energjisë është besueshmëria e shërbimeve të energjisë. Disponueshmëria energjetike e shtetit mund të rritet duke investuar në burime alternative të energjisë, diversifikimin e burimeve nga të cilat fitohet energjia. Nën elementin e tretë të sigurisë së energjisë nënkuptojmë përbalueshmërinë ose disponueshmërinë e energjisë me çmime të arsyeshme, transparente dhe të parashikueshme. Për shembull, çmimi i naftës që nga fundi i shekullit XIX ishte pothuajse relativisht stabil, dhe nuk ishte nën pesë dollarë për një fuçi të naftës. Megjithatë, për shkak të embargos së naftës që anëtarët e OPEC e kanë vendosur kundër shteteve që mbështetnin Izraelin në luftën e katërt Arabo-Izraelite, i njohur gjithashtu si lufta - Yom Kippur, çmimi i naftës në tregun botëror në vitin 1973, brenda natës u katërfishua. Kjo pati pasoja negative për ekonominë botërore. Së fundi, elementi i katërt dhe i fundit i sigurisë së energjisë është qëndrueshmëria e mjedisit. Edhe pse ky element nuk është pjesë e përkufizimit të ngushtë klasik të sigurisë energjetike, sot është e pamundur të anashkalohet efekti të cilin e përdor energjia që ka në ndryshimet klimatike dhe ndotjen e mjedisit. Kërcënimet ekonomike të sigurisë kombëtare

⁹⁸ Rice, Graff and Pascual, 2010.

⁹⁹ Kjo mund lehtë krahasohet me indeksin e shteteve të dobëta, të publikuar nga institucioni Brookings, dhe raporte të ndryshme ekonomike, të publikuar nga Banka Botërore dhe FMN.

¹⁰⁰ Rice, Rice, Graff and Pascual, 2010, 7.

¹⁰¹ Collier and Hoeffler, 2004.

¹⁰² Citirano sipas Cohn, 2009.

¹⁰³ Yergin, 2006.

¹⁰⁴ Pascual and Elkind, 2010, 122.

mund të vijënë nga struktura e tregut global. Për sa kohë që shtetet janë të integruara në tregun botëror, ato do të jenë të ndjeshme dhe të prekshme ndaj çrregullimeve që ndodhin në shtetet tjera. Duke pasur parasysh se shumica e burimeve në të cilat ato varen nuk mbështetet në fuqinë e tyre, por në tregun global, në rast të çrregullimit të tregut do të prishet dhe gjendja e tyre e brendshme ekonomike, dhe kështu situata sociale, politike dhe nganjëherë edhe situata e sigurisë së brendshme.

Shembull klasik i kësaj është rënia e berzës në New York Stock në tetor të vitit 1929. Kjo ngjarje botën e ka futur në periudhën e Depresionit të Madh, e cila zgjati deri në fund të viteve të tridhjeta. Kriza shpejt u përhap në Evropë dhe në pjesën tjetër të botës kapitaliste dhe kontribuoi në rritjen e nazizmit si dhe shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore. Kriza globale ekonomike që përfshiu për herë të parë SHBA-në në vitin 2008, është kriza më e madhi globale ekonomike që nga Depresioni i Madh. Ajo gjithashtu u shfaq në tregun financiar amerikan dhe shumë shpejt në masë më të madhe apo më të vogël, e futi në periudhë recesioni gjithë botën. Megjithatë, ndryshe nga vitet e tridhjeta, sot ka mekanizma të fortë mbrojtëse brenda shtetit siç u dëshmuua nga fakti që SHBA-ja ka subvencionuar vetëm bankën amerikane me 700 miliardë \$. Përveç kësaj, sot ka një rrjet të fortë mbrojtës në nivel ndërkombëtar i përbërë nga institucionet ndërkombëtare, siç është Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, BE e tj. Shtetet në raste të caktuara tregun e lirë global e përjetojnë si kërcënim ndaj sigurisë së tyre ekonomike. Ato kundër globalizimit mund të luftojnë me proteksionizmin brenda kufijve kombëtarë (për shembull, Koreja e Veriut, Venezuela, Zimbabve, Kubë) ose brenda blloqeve rajonale ekonomike (psh. Të BE, NAFTA). Qëllimi i blloqeve ekonomike rajonale, siç është BE, është që të sjellë në një lloj mbrojtje nga ndikimi i vazhdueshëm i konkurrencës globale, dhe njëkohsisht brenda kufijve të këtyre blloqeve të ruhet tregtija e lirë dhe në këtë mënyrë të përfitojnë nga të mirat e konkurrencës dhe të tregut të lirë. Shtetet mund ta shikojnë globalizimin ekonomik si kërcënim ekonomik apo politik për shkak të anës së saj të errët. Liberalizimi i ekonomisë botërore në dekadat e fundit ka mundësuar lëvizje e lirshme dhe me kosto më të vogël të njerëzve, mallrave, punës dhe kapitalit, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin ekonomik. Komunikimi i lehtësuar ka mundësuar zhvillimin e lidhjeve transnacionale, të cilat çuan në nivel më lartë zhvillimin e shoqërisë civile globale. Megjithatë, globalizimi ekonomik ka lehtësuar edhe tregtinë e paligjshme të drogës, armëve dhe njerëzve. Ashtu siç është lehtësuar të lidhë ekonominë, në të njëjtën mënyrë është lehtësuar edhe rrjetëzimi (lidhshmëria) transnacionalë e grupeve të organizuara kriminale dhe organizatave terroriste.¹⁰⁵ Së fundi, globalizimi mund të përjetohej si kërcënim për sigurinë shoqërore, nëse bashkimi dhe standardizimi që e sjellë tregu global i kërcënojnë format tradicionale kulturore, apo identiteti kombëtar.

Së fundi, globalizimi mund të përjetohej si kërcënim për sigurinë shoqërore ku ai konsiderohet se bashkimi dhe standardizimi i sjellë nga tregun global kërcënojnë format tradicionale kulturore, apo identiteti kombëtar.¹⁰⁶

3.3. Kërcënimet ekonomike në nivel të sistemit ndërkombëtar

Së fundi, në nivel të sistemit ndërkombëtar si kërcënim sigurie në diskursin politik shpesh theksohet rënia e kapitalizmit gjegjësisht përplasja e rendit liberal ekonomik ndërkombëtar. Mënyra kapitaliste sot është mënyra e të bërit biznes në shumë pjesë të botës dhe ka arritur statusin e rutinës, pa të cilat jeta është pothuajse e paimagjinueshme. Siç tregon një paradoks filozofi slloven Slavoj Žižek. Ai thekson, se friga e ekzpozuar për fundin e planetit dhe racës njerëzore, si dhe vizionet të ndryshme apokaliptike është e përditshme, kurse gjëja e vetme që nuk mund të imagjinohej, është fundi i kapitalizmit. Kjo është ndoshta e vërtetë në nivelin e kulturës masive, ose në nivelin dominant të teorisë shoqërore qytetare.¹⁰⁷

Por në nivelin e marrëdhënieve ndërkombëtarë faktorët që vendosin, para se gjithash përfaqësuesit e shteteve të mëdha kapitaliste, janë të shqetësuar se rendi liberal ekonomik ndërkombëtar i ruan në jetë. Siç shkruan Buzan, Waever dhe De Wilde: *struktura në nivel të sistemit (të tregut, sistemit tregtarë, sistemin financiare) dhe institucionet që janë të lidhur me to, janë të lidhura në mënyrë rutinore si objekt sigurimi.*¹⁰⁸

Kjo është në kundërshtim me diskursin në sektorin politik, të cilët, edhe pse regjimet e ndryshme dhe institucionet, madje edhe shoqëritë ndërkombëtare për veten e tyre mund të bëhen objekte referuese, struktura anarkike si të tillë pothuajse asnjëherë nuk trajtohet në këtë mënyrë.

Rendi ndërkombëtar liberal ekonomik mund të rrezikojë gjithçka që ndalon lirinë e rrjedhjen ndërkufitare të mallrave, shërbimeve ose kapitalit. Ato mund të jenë monopolet dhe proteksionizmi brenda shtetit, por gjithashtu mund të jenë edhe faktorët që e pengojnë tregtinë e lirë mes shteteve. Për shembull, NATO, BE-ja dhe Federata Ruse kanë dërguar flotat e tyre në Gjirin Aden për ti mbrojtur nga piratët somalezë kompanitë individuale të transportit, të cilat bartin mallra nga njëri skaj i botës në tjetrin.¹⁰⁹

¹⁰⁵ Gleni, 2008.

¹⁰⁶ Fabbrini 2004.

¹⁰⁷ Film Dokumentar: Astra Taylor. Žižek, viti 2005.

¹⁰⁸ Buzan et. al., 1998, 106.

¹⁰⁹ Middleton, 2008.

4. PËRFUNDIM

Siguria ekonomike është një koncept që ka filluar të përdoret në vitet e herëshme të shtatëdhjetave të shekullit XX dhe sot është pjesë e pandashme e diskursit të sigurisë. Megjithatë, siç u përmendë, ka kuptime të ndryshme të nocionit të sigurisë ekonomike. Sektori i sigurisë ekonomike përfshin dinamikën e sigurisë, në të cilat është dominante tregtia dhe raportet e prodhimit. Nga niveli i analizës do të varet edhe objekti i referimit në sektorin ekonomik. Në nivel individual, ajo është e mirëqenies ekonomike. Në nivel të shoqërisë, ajo mund të jetë ndërmarje apo klasë. Kur është fjala për sigurinë kombëtare, objekti i referimit është prosperiteti ekonomik, ndërsa në nivel ndërkombëtar ajo e rendit liberal ekonomik ndërkombëtar. Secila prej këtyre objekteve të referimi i ndjekin edhe aktorët e sekuritarizmit, të cilët kanë kapital shoqëror dhe politik që këtë objekt e ndërtojnë sikurse është i rrezikuar dhe në emër të tyre fitojnë legjitimitetin për zbatimin e masave të veçanta. Së fundi, në pjesën e tretë është bërë shqyrtim për kërcënimet dominuese ekonomike ndaj sigurisë. Në nivel individual, këto janë kryesisht varfëria, uria dhe sëmundjet. Në nivel shtetëror, janë varfëria, pasiguria e energjisë apo kërcënimet që vijnë nga struktura ekonomike ndërkombëtare, bëhet fjalë për rënien ndërkombëtare të rendit liberal ekonomik, ndonjë nga efektet anësore të tregut të lirë, të tilla si trafikimi ilegal, krimi të organizuar apo terrorizmit ndërkombëtar. Së fundi, në nivelin e sistemit ndërkombëtar, kërcënim i rëndësishëm ekonomik është rënia e kapitalizmit dhe rënia e rendit liberal ekonomik ndërkombëtar.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Buzan et. al., 1998, 106.
Buzan, 1984.
Cable, 1995.
Collier and Hoeffler, 2004.
De Souza, 2000.
Fabbrini 2004.
Film Dokumentar: Astra Taylor. Zhizhek, viti 2005.
Gleni, 2008.
Hough, 2004.
Hough, 2006, 86.
Middleton, 2008.
National Security Strategy of the United States, August 1991
National Security Strategy of the United States, May 2010,
Pascual and Elkind, 2010, 122.
Pol Kenedi, 2003
Rice, 2010.
Rice, Graff and Pascual, 2010,7
Yergin, 2006.
Wolfers, 1952, 482.